

Në bazë të Nenit 35, paragrafit 1, nënparagrafit 1.1 të Ligjit nr.03/L-209 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010) dhe nenit 114 të Ligjit nr.04/L-093 mbi Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11 / 11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 22 dhjetor 2015, miratoi si vijon:

RREGULLORE
PËR SHPËRNDARJEN E MJETEVE TË KREDISË PËR INSTITUCIONET
MIKROFINANCIARE DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e praktikës së shpërndarjes së mjeteve të kredisë tek huamarrësit.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha institucionet mikrofinanciare, dhe degët e huaja të IMF-ve (në vijim: IMF-të) si dhe institucionet financiare jobankare me aktivitete të kredidhënies (në vijim: IFJB) të regjistruara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2
Përkufizimet

1. Të gjitha përkufizimet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me përkufizimet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit nr.04/L-093 për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare dhe / ose me përkufizimet në vijim për qëllim të kësaj rregulloreje:
 - a) *Degë e IMF-së së huaj apo degë e një institucioni tjetër financiar të huaj* - do të thotë personi juridik, i cili ka selinë e vet kryesore dhe është i licencuar për të ushtruar veprimtari mikrofinanciare në një juridiksion tjetër përveç Republikës së Kosovës;
 - b) *Mjete të kredisë* - nënkupton parat e gatshme të shpërndara për kreditë e lejuara nga IMF-ja apo IFJB-ja.

Neni 3 **Kërkesat**

1. Shpërndarja e kredisë në shumën deri në dhjetë mijë (10,000) euro mund t'i ofrohet klientit drejtpërdrejt nga IMF-ja apo IFJB-ja , përveç nëse kjo është e kufizuar në ndonjë shumë më të vogël me legjislacionin në fuqi, ose përmes llogarisë së tij bankare, ku më pas klienti mund t'i tërheqë ato në para të gatshme.
2. Mjetet e kredisë në shumë mbi 10,000 euro (dhjetë mijë euro) sipas kërkesës së kredimarrësit duhet të transferohen nga llogaria bankare e IMF-së apo IFJB-ja në llogarinë e furnitorit vetëm pas autorizimit të këtij transaksioni nga ana e IMF-së apo IFJB-së.
3. IMF-ja apo IFJB-ja autorizon transaksionin nga paragrafi 2 i këtij neni vetëm nëse një transfer i tillë bankar është i mbështetur me dokumentet valide si në vijim:
 - a) Fatura (Profatura mund të shfrytëzohet si dokument valid deri në momentin e realizimit të transaksionit), apo vërtetimi për parapagim i lëshuar nga institucioni kredidhënës, në rastet e parapagimit të kredive; ose
 - b) Kontrata e shitblerjes e vërtetuar nga organet kompetente (noteri apo gjykatë).
4. Në rastet specifike kur shfrytëzimi i mjeteve të kredisë nuk mund të mbështetet me dokumentacionin e përcaktuar me paragrafin 3 të këtij neni, mjetet e kredisë në shumën mbi 10,000 euro (dhjetëmijë euro) duhet të transferohen në llogarinë bankare të kredimarrësit dhe pastaj mund të shfrytëzohen nga kredimarrësi për pagesë ndaj furnitorëve të tjerë apo të tërhiqen në para të gatshme nga kredimarrësi, përderisa shfrytëzimi i tyre të jetë i dokumentuar nga kredimarrësi për IMF-në apo IFJB-në.
5. IMF-të apo IFJB-të për të qenë në pajtueshmëri me paragrafët e këtij neni nuk duhet të strukturojnë transaksionet në mënyrë që t'i shmangen kërkesave të paragrafëve të këtij neni.
6. IMF-të apo IFJB-të për të qenë në pajtueshmëri me paragrafët e këtij neni, duhet të sigurojnë një sistem të kontrollit të brendshëm, i cili do të sigurojë shpërndarjen e mjeteve të kredisë sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 4 **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe dënimeve civile, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.

Neni 5

Shfuqizimet

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregulla e BQK-së XXIX mbi Pagesën Direkte dhe Indirekte të Kredive në Para të Gatshme, e miratuar nga Bordi i BQK-së me date 31 tetor 2007 dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi me datën 01 janar 2016.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikë së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci